

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këlliçi akuzon Ramën pas kthimit nga SHBA: “Kryehajdut i shqiptarëve dhe kre i narkoshtetit”, i rrethuar nga Balluku, Agasi, Vlora e Beqiri
ADRESA	https://albeu.com/lajme/kellici-akuzon-ramen-pas-kthimit-nga-shba-kryehajdut-i-shqiptare-ve-dhe-kre-i-narkoshtetit-i-rrethuar-nga-balluku-agasi-vlora-e-beqiri/1030002/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:30:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:27:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bb422e4bfd640482d5366607f79acb0439a0825f884ea89d17da7c115eaeadd8
TEKSTI	8b36f2764e17f083fbfaf9257e750b5dfacd6b9d0678bb6233f43db9b41d123e
PAMJA	5036cb9936b5d47443e65fe5c20b54cedcdf537a42b1e8c9ccf71c76c3405a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9eea3bf1454b57c2cf6d7e92de7f58b8611ce9f334eeb9b295ed9eee20e0c558
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9eea3bf1454b57c2cf6d7e92de7f58b8611ce9f334eeb9b295ed9eee20e0c558>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Këlliçi akuzon Ramën pas kthimit nga SHBA: “Kryehajdut i shqiptarëve dhe kre i narkoshtetit”, i rrethuar nga Balluku, Agasi, Vlora e Beqiri



Belind Këlliçi, nënkryetar i Partisë Demokratike, ka reaguar ndaj deklaratave të kryeministrit Edi Rama pas rikthimit nga Shtetet e Bashkuara, duke e akuzuar atë për përgjegjësi në një varg çështjesh që, sipas tij, kanë dëmtuar qeverisjen e vendit.

Ai u shpreh se Rama, edhe pse kishte paralajmëruar një konferencë për shtyp në Rinas, preferoi të mbajë një monolog dhe të shmangë ballafaqimin me pyetjet e gazetarëve.

Lidhur me vizitën e Ramës në Nju Jork, Këlliçi kritikoi si fjalimin ashtu edhe takimet e kryeministrit gjatë qëndrimit në SHBA. Sipas tij, kryeministri u prit me protesta dhe nuk arriti të realizojë takimet e njoftuara paraprakisht; ai pretendoi se takimet e vetme që Rama arriti të zhvillojë ishin ato me Taulant Ballën dhe Pjerin Ndreun.

Në vijim, Këlliçi parashtrroi një sërë akuzash kundër kryeministrit, duke përfshirë çështje që lidhen me deklarin e pasurisë, inceneratorët, koncesionet, Portin e Durrësit dhe procedurat e prokurimeve publike. Ai e mbylli deklaratën duke kërkuar dorëheqjen e menjëhershme të Edi Ramës.

Në deklaratën e tij drejtuar qytetarëve, Këlliçi tha se Rama i thirri gazetarët në Rinas për një konferencë të jashtëzakonshme, por, i frikësuar nga pyetjet, iu rikthye monologut të zakonshëm. Sipas tij, kryeministri foli si i përhumur për armiq të brendshëm dhe për suksese që, sipas Ramës, këto armiq po i pengojnë.

Këlliçi e lidhi këtë qëndrim me atë që ndodhi në Nju Jork, ku sipas tij Rama foli për inteligjencën artificiale dhe e akuzoi popullin e vet si antisemit në një sallë pothuajse bosh, ndërsa Vuçiçi e përmendi Kosovën. Ai shtoi se kryeministri u prit me protesta që në takimin e parë në Michigan, dhe pas një bojkoti tërësor, i vetmi rezultat ishin takimet me Taulant Ballën dhe Pjerin Ndreun.

të fundit/



Vedat Muriqi merr përgjegjësinë pas humbjes me Austrinë:...



Volkswagen zgjeron hapësirën e ngarkesës te furgoni elektrik ID....



Atmosferë e tensionuar para Irlandë-Izrael: futbollistët irlandezë...



Mijëra persona në Prishtinë në tubim përkrah ish-...



Zgjedhja e Presidentit e vendos Kosovën përballë rrezikut të nj...



Zhegrova pas disfatës me Austrinë: Jam në formë dhe gati për...



Fisnik Asllani pas disfatës ndaj Austrisë: Jam gati të startoj...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

me tej, këllçi u shpreh se Rama u kthye nga një detyrë për të protestuar dhe përçmim, pas shpenzimeve të mëdha që i përkasin vetëm kreut të një "narko-shteti". Ai shtoi se fjalimi për Diellën, i përgatitur me ChatGPT, ngjalli neveri. I rënduar nga çështjet që rrethojnë qeverisjen e tij, në vend që të dilte para gazetarëve siç kishte njoftuar, Rama u fsheh pas një monologu turpërues. Motoja e tij ishte: "Mos mendoni se ju kam vjedhur".

Këllçi më pas akuzoi Ramën se, në këtë monolog vetposhtërues, bëri avokatinë e Vlora Hysenit, njësoj siç bëri më herët me Lubinë. Ai e përshkroi Hysenin si një zyrtar pa moral, pa dinjitet dhe pa ndjenjë atdheu, e emëruar në një post me besim të lartë shtetëror në shkelje të çdo kriteri. Sipas tij, merita e vetme e Hysenit ishte shkarkimi nga autoritetet e Kosovës për grabitje dhe dorëzimin në Beograd të të dhënave të Shërbimit Informativ të Kosovës.

Ai shtoi se kjo avokati dëshmon se Rama nuk është peng vetëm i Lubisë, bashkëhajdutes dhe noteres së vjedhjeve të tij 27-vjeçare, por edhe i Ergys Agasit, Ermal Beqirit dhe Vlora Hysenit. Sipas tij, Hyseni, si anëtare kryesore e kësaj organizate kriminale, si shërbëto e karteleve të drogës dhe si "kurizane" e koordinatorit të bandave, vuri në shërbim të këtyre grupeve, me miratimin e Ramës, Shërbimin Informativ Shtetëror, sigurinë kombëtare dhe sekretet që NATO-ja u beson shteteve anëtare.

Këllçi theksoi se pretendimet e Ramës se nuk ka vjedhur, në realitet provojnë të kundërtën.

Ai e akuzoi Ramën se ka shkarkuar në mënyrë antikushtetuese kryetaren e ILDKP-së, menjëherë pasi ajo nisi hetimin për pallatin pesëkatësh të bashkëshortes së tij, të marrë si pajë. Sipas tij, kjo ndërtesë nuk ka fatura doganore, tatimore, bankare apo ndërtimore dhe u ndërtua nga një kompani që fitoi qindra milionë euro në tendera.

Në të njëjtën linjë, Këllçi tha se Rama shkarkoi kryetaren e ILDKP-së në shkelje të Kushtetutës, sapo ajo filloi hetimin për "sarajet" e tij, të cilat kanë themele 57 metra të gjata dhe një park prej 8,300 metrash katrorë, më të mëdha se Pallati Presidencial. Ai vuri në dukje se këto u ndërtuan në një kohë kur Rama kishte deklaruar vetëm 3,800 euro dhe 400 mijë lekë kurseje.

Ai kujtoi gjithashtu se Rama është akuzuar në një raport zyrtar të OSBE-së të vitit 2014 për 200 milionë euro të fshehura në banka offshore.

Këllçi theksoi se Rama ka firmosur personalisht dhënien e 130 milionë eurove për inceneratorin e Tiranës, tetë muaj para se të krijohet kompania të cilës iu dha kontrata.

Ai e akuzoi Ramën se është përballur me akuzat të drejtpërdrejta për transportimin jashtë shtetit, me avionin e tij, të qindra valixheve me euro, por se ai refuzoi krijimin e një komisioni hetimor parlamentar.

Këllçi e quajti Ramën "kryehajdut i shqiptarëve" dhe autorin e vërtetë të koncesioneve të sterilizimit, Check-Up-it dhe analizave, përmes të cilave, së bashku me ministrat e tij, pretendohet se janë vjedhur të paktën 300 milionë euro.

Ai shtoi se Rama, së bashku me "Alabarin" e tij, ka vjedhur tokë publike me vlerë 3 miliardë euro në Portin e Durrësit.

Sipas Këllçit, Rama është i vetmi kryeministër që i ka përdorur mandatet parlamentare për të bllokuar drejtësinë dy herë: nuk hoqi imunitetin e Saimir Tahirit, sepse, sipas tij, kishte ndarë me të fitimet e trafikëve, dhe nuk hoqi imunitetin e Ballukut, pasi dosja e kësaj të fundit, me qindra milionë euro në tunelin e Llogarasë, Unazën e Madhe të Tiranës, Rrugën e Arbrit, Aeroportin e Vlorës dhe rrugën Qukës-Qafë Pllaçë, është para së gjithash dosja e vetë Ramës.

Ai e cilësoi Ramën si kryehajdut të shqiptarëve në gjithë historinë e tyre dhe e akuzoi se, për të shkatërruar sistemin e prokurimeve, shpiku modelin "KAYO", përmes të cilit mallrat e blera me paratë publike i shiten qeverisë së tij të korruptuar, ndërsa fitimi ndahet me të.

Këllçi vijoi duke thënë se Rama mund ta kthejë konferencën për shtyp në monolog, por sot çdo shqiptar, në fytyrën e tij të nxirë, sheh fytyrat kriminale të Lubisë, Ballukut, Ergys Agasit, Ermal Beqirit, Vlora Hysenit, Linda Karçanajt dhe të tjerëve. Prandaj, sipas tij, Rama nuk ka më fytyrë dhe guxim të dalë përpara gazetarëve.

Në fund, Këllçi njoftoi se Partia Demokratike dënon me forcën më të madhe Edi Ramën, si kreun e narko-shtetit të parë dhe të vetëm në Europë, si kryehajdutin më të madh të shqiptarëve dhe si kreun e një sistemi llumrash, Ballukësh, Agasish, Hysenish, Beqirësh e qindra të tjerë, që sipas tij kanë ndërtuar në Shqipëri shtetin e hajdutëve dhe mafies. Ai kërkoi dorëheqjen e menjëhershme të kryeministrit si kusht themelor për zgjidhjen e krizës së thellë që ka kapluar vendin.

Shtuar më 27.09.2026 21:27

Tags: -Politikë , kryesore , Lajmet e fundit , Shqipëria , Të Gjitha





E rëndë në Fier/ Banesa u përfshi nga flakët, çatia i ra në kokë, humb jetën i...



Arben Kola: Ramën e braktisën në SHBA, Vlorë Hyseni spiunazh kundër...



Aksident tragjik në Cërrik/ U përplas me shtyllën, humb jetën 21-vjeçari



Slatina e Mokrës në Pogradec, po zbrazet nga banorët: Na mungon zëri ...



Vuçić jep dorëheqjen nga posti i presidentit të Serbisë, zhvillon telefona...



Rama: Nuk ka bir nëne që gjen një qindarkë të tijën në xhepin tim! Pushtetin nuk...



Rama: Llogaritë e Vlorë Hysenit me drejtësinë është një çështje individuale, kj...



Hetimi i ish-drejtuës së SHISH/ Edi Rama: Nuk është hera e parë që kre...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtua është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.